



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME KORÇË

Nr 317 prot

Korçë më 19.09.2024

**Lënda:** Njoftim për vend të lirë

**Drejtuar :** Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive  
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore  
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun

**Tiranë**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së, Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

Mësimdhënës i Teorisë dhe Praktikes Profesionale me kohë të plotë, për "Degën Hoteleri - Turizëm".

**1.Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë dhe praktikës profesionale në Shkollën Profesionale Shërbime, Korçë janë:**

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- m) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- n) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- o) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- p) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- ë) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit

Aplikanti duhet të plotësoje Kriteret e posaçme si vijon:

- g) Të ketë diplomë Përkatëse niveli Master profesional ose të barazvlefshem me të , në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.
- h) Të ketë të paktën 3 (tre) vite eksperiencë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

## 2. Dokumentet e aplikimit

4. Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :
- a) Letër motivimi për pozicionin;
  - b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 të këtij udhëzimi
  - c) Kartën e identitetit,
  - d) Diplomën
  - e) Librezën e punës
  - ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
  - f) Çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
  - g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
  - gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
  - h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
  - d) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës.....20.09.2024

TATIANA MERO  
DREJTORI SHKOLLËS

